



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 451-14229/2024

Klinë, më 25/04/2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, botuar në gazetën zyrtare, nr 28 më dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, nenin 2 pika 2.3 dhe nenit 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-49, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e SPAK, nr.01-400-11026/2024 të datës 02.04.2024, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori**;

V E N D I M

1. **LEJOHËT**, ndarja e mjeteve financiare në shumën prej 1,700.00 € (njëmijë e shtatëqind euro) për Shoqatën Sindikale të Shërbyesve Civil në Klinë. Mjetet ndahen më qëllim të realizimit të vizitës për nder të 1 majit, të Shërbyesve Civil të Administratës komunale në Klinë, sipas kërkesës, nr.01-400-11026/2024 të datës 02.04.2024. Mjetet në shumën prej 1,700.00 € paguhen nga subvencionet e zyrës së kryetarit.
2. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi derdhen në xhirollogarinë e Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës, të cilat i destinohen degës në Klinë.
3. Obligohet, përfaqësuesi i Shoqatës Sindikale, qe për mjetet e ndara në shumën e lartcekur Komunës së Klinës, t'ia paraqes raportin zyrtar të shpenzimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, në bashkëpunim më Zyrën e Kryetarit.
5. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- SPAK, SHSSHC- Klinë;
- DFEZH;
- Arkivi.

